



Dragash, 16.07.2021

Drejtoria Për Kulturë Rini e Sport u bën:

THIRRJE PUBLIKE

1. Të gjitha Organizatave Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Dragashit, programi i punës i së cilave është i fokusuar në fushën e sportit dhe rinisë dhe turizmit, dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Dragashit të aplikojnë për mbështetje financiare mbi:

Në fushën e sportit

- ✓ Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive
- ✓ Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive dhe shkollave të sportit për grupmoshat e reja

Në fushën e rinisë dhe turizmit:

- ✓ Fuqizimi i rinisë
- ✓ Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore në zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjtë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në nxitjen e aktiviteteve në fushat e ndryshme
- ✓ Promovimi i turizmit në Dragash

Vlerësimi profesional do të bëhet nga komisioni profesional prej 5 anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregullores për kushtet, Kriteret për Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

2. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare:

1. Shuma minimale e mbështetjes që mund të alokohet nga fusha e sportit është **1.000 euro**, kurse shuma maksimale është **13.500 euro**.
2. Shuma minimale e mbështetjes që mund të alokohet nga fusha e rinisë dhe turizmit është **1.000 euro**, kurse shuma maksimale është **3.500 euro**.

3. Vlerësimi do të bëhet sipas:

1. Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit;
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes;
3. Kapacitetit të dëshmuar organizativ dhe menaxhues;
4. Vazhdimësisë së realizimit të programit për afirmimin ndërkombëtarë të Komunës së Dragashit
5. Cilësisë artistike të projektit;
6. Originalitetit të projektit.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:

- ✓ Formulari i aplikacionit për projekt/ program
 - ✓ Formulari i propozim-buxhetit
 - ✓ Deklarata për mungesë të financimit të dyfishtë
 - ✓ Formulari për konflikt interesi
 - ✓ Dokumenti identifikues (fotokopje e shtypur)
 - ✓ Certifikata e regjistrimit të OJQ-së dhe Numri Fiskal (fotokopje e shtypur)
 - ✓ Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit
 - ✓ Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore ndaj ATK-së, jo më të vjetër se 6 muaj
 - ✓ Dëshmi të implementimit projekteve/ programeve të ngjashme
5. Formulari për aplikim mund të merret në web-faqen e Komunës dhe mund të dorëzohet nga **16.07.2021 deri më 05.08.2021 (15 ditë pune)**. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e Prokollit (Arkivi) Nr. 1, në ndërtesën e Komunës së Dragashit
Për: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

6. Aplikimet

1. OJQ-të në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo- Qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në teritorin e Komunës së Dragashit.
3. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e aplikimit.
4. OJQ-të duhet pashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovë dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së

- Dragashit- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
- Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Dragashit.
 - Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
 - Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Vërejtje:

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave. Për çdo informatë dhe për të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen dhe në mënyrë elektronike, duke dërguar email në adresën dkrs.dragash@gmail.com

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNEA E DRAGASHIT
Opinion Dragash

19 Nr. Nr. 400/01-14248/21

16.07.20 20 21
Dragash - Dragash



Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport

Lirim Hajredini